



Memorandum Mirëkuptimi

në mes

Kosova – Women 4 Women

dhe

Komuna e Drenasit

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar	22.06	2020	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01 -	400 -	213.55	

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejshëm i referuar si 'Memorandumi') ka për synim krijimin e partneritetit mes Kosova -Women 4 Women (në vazhdim i referuar si 'KW4W') dhe Komunës së Drenasit (në vazhdim i referuar si 'Komuna').

Ky dokument nuk paraqet marrëveshje që i lidh palët ligjërisht në implementim të aktiviteteteve të ndryshme për synime të përbashkëta, mirëpo i elaboron kushtet në bazë të të cilave do të funksionojë ky bashkëpunim si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

I. Objektivat e bashkëpunimit

Qëllimi i Memorandumit është që të ofrojë kornizën e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes palëve me qëllim të fuqizimit ekonomik dhe social të grave të kësaj komune dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në procese të ndryshme vendimmarrëse dhe afariste.

II. Rolet dhe përgjegjësitë

Duke e nënshkruar këtë memorandum, palët pajtohen t'i përmbushin rolet dhe përgjegjësitë në vazhdim:

a. KW4W do të ketë përgjegjësi:

- Të bëjë mobilizimin e grave dhe burrave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
- Të bëjë organizimin e trajnimeve,
- Ti koordinoj aktivitetet me zyrtarë/et komunale

R. L

b. Komuna do të ketë përgjegjësi:

- Të emëroj një zyrtar/e si person kontaktues për koordinim të aktiviteteve,
- Të bashkëpunojë në mobilizimin e grave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
- Aty ku është e mundur të ofroj hapësira për nevoja të aktiviteteve dhe projekteve

III. Konfidencialiteti

Të dyja palët pajtohen që të dhënat dhe informatat që merren/grumbullohen përgjatë këtij bashkëpunimi do të trajtohen me konfidencialitet dhe sipas ligjeve të Kosovës. Edhe pas përfundimit të projektit informatat personale të rasteve mund të përdoren vetëm me miratimin me shkrim të tyre.


IV. Kohëzgjatja e Memorandumit të Mirëkuptimit

Ky memorandum hyn në fuqi me datën e nënshkrimit dhe do të mbesë në fuqi deri në rastin e modifikimit apo ndërprerjes nga ndonjëra palë. Në rast se ndonjëra palë dëshiron ta ndërpresë marrëveshjen, duhet të bëhet njoftim me shkrim 1 muaj përpara se marrëveshja të konsiderohet e ndërprerë.

V. Autorizimi

Duke e nënshkruar këtë memorandum, të dyja palët pajtohen që t'i përmbushin termet e saj në mirëbesim. Edhe pse kjo marrëveshje nuk është obligative ligjërish për ta implementuar, ajo është dëshmi e përkushtimit për t'i zbatuar rolet dhe përgjegjësitë e paracaktuara në këtë marrëveshje.

Kosova - Women 4 Women




Emri: Iliriana Gashi


Titulli: Drejtore

Adresa: Arbëria III, Rruga Kosturi,
nr. 69

10000 Prishtina

Data: 22.06.2020

Kuvendi Komunal Drenas




Emri: Ramiz Lladrovci

Titulli: Kryetar i Komunës

Adresa: Rruga "Fehmi dhe Xhevë
Lladrovci"

13000, Gillogoc

Data: 22.06.2020